



Konferenca virtuale në mënyrë të sigurt MM|MARS 2021

Çfarë është konferenca virtuale?

Pas rekomandimeve të distancimit shoqëror për shkak të COVID-19, shumë organizata kanë zhvendosur konferencat e tyre personale në takime virtuale. Po ashtu shumica nga ne jemi duke punuar nga shtëpia, ka shumë të ngjarë që po e gjeni veten në situata kur duhet të lidheni nga distancë me bashkëpunëtorët tuaj duke shfrytëzuar zgjidhjen e konferencave virtuale sikurse Zoom, Slack ose Microsoft Teams. Pavarësisht nga arsyeja se pse po lidheni, këtu janë hapat kryesorë që mund të ndërmerreni për të përfituar sa më shumë nga këto teknologji në mënyrë të sigurt.

Pjesëmarrja në konferencë virtuale

Nëse po ndiqni një konferencë virtuale këta janë pesë hapat të cilët duhet ndjekur:

1. **Azhurnimi i Softuerit.** - Sigurohuni çdo herë që jeni duke e përdorur versionin më të fundit të softuerit për konferencë. Sa më i ri dhe i përditësuar të jetë softueri juaj, aq më i sigurt do të jeni.
Mundësoni përditësimin automatik dhe ndaleni programin kur të mbaroni, në mënyrë që të mund të kontrollohet për përditësimet e fundit herën tjetër kur rifilloni.
2. **Konfiguro rregullimet për zë (Audio) / Pamje (Video).** - Vendors preferencën tënde për ndaljen e mikrofonit dhe videos kur i bashkoheni takimit dhe t'i ndizni ato kurdo që dëshironi. Keni parasysh mbulimin e kamerës së kompjuterit tuaj me një mbulesë ose shirit për të siguruar privatësi kur nuk transmetoni në mënyrë aktive. Mos harroni: nëse kamera juaj është e ndezur, të gjithë mund të shohin se çfarë jeni duke bërë edhe atëherë kur nuk jeni duke folur.
3. **Kontrolloni dy herë se çfarë ka prapa jush.** - Nëse doni ta ndizni web-kamerën, keni kujdes se çfarë keni pas jush. Sigurohuni që të mos keni ndonjë informatë personale ose të ndjeshme e cila shihet gjatë thirrjes. Disa softuerë të video konferencave ju mundësojnë të mjegulloni ose shfrytëzoni sfondin virtual, kështu që njerëzit nuk mund të shohin çfarë ka pas jush.

4. **Mos e ndani ftesën tuaj.** - Linku i ftesës është bileta juaj personale për t'ju bashkuar takimit. Madje edhe nëse një bashkëpunëtori të besueshëm i nevojitet linku, është shumë më mirë që ata të kërkojnë ftesën e tyre nga organizatori i konferencës.
5. **Mos incizo.** - Mos fotografo pamjen (screenshot) dhe mos inçizo konferencën pa kërkuar leje. Ju aksidentalisht mund të ndani informacione shumë të ndjeshme nëse ato pamje ose regjistrime të ekranit bëhen publike.

Të jesh nikoqir i konferencës virtuale

Nëse do të jeni nikoqir i konferencës virtuale, këtu janë disa hapa shtesë të cilët duhet t'i ndërmerreni:

1. **Kërko Fjalëkalim.** - Për të mbrojtur privatësinë dhe sigurinë e konferencës tuaj dhe të kontrolloni se kush po ju bashkohet, atëherë takimi i juaj duhet të jetë i mbrojtur me fjalëkalim. Në këtë formë, vetëm ata të cilët kanë fjalëkalimin e konferencës mund t'i bashkohen konferencës.
2. **Rishiko pjesëmarrësit.** - Rishiko personat të cilët janë duke e ndjekur ngjarjen. Nëse ka ndonjë që nuk e njihni ose nuk mund ta identifikoni, atëherë e ftoni personin që të konfirmoj identitetin e tij. Nëse keni ndonjë shqetësim ose nëse dikush është i vrazhdë ose përçarës, largojeni nga konferenca. Shumë zgjidhje ofrojnë mundësinë për ta mbyllur konferencë sapo ajo të ketë filluar, kështu që askush tjetër nuk mund të bashkohet nëse ju nuk e lejoni.
Një mundësi tjetër mund të jetë vendosja e njerëzve fillimisht në një dhomë virtuale pritjeje, në mënyrë që të mund të aprovonë kush i bashkohet thirrjes.
3. **Informoni nëse regjistroni.** - Nëse keni ndërmend të regjistroni ngjarjen (dhe keni leje për të regjistruar), sigurohuni që të informoni të gjithë në konferencë para kohe.
4. **Ndarja e ekranit tuaj.** - Nëse do të ndani ekranin e kompjuterit tuaj në çdo moment, sigurohuni që së pari të mbyllni të gjitha aplikacionet e tjera dhe të hiqni çdo skedar të ndjeshëm nga ekranin e kompjuterit tuaj. Ç'aktivizoni gjithashtu çdo njoftim pop-up. Kjo ndihmon që të mos ndani aksidentalisht informacione të ndjeshme ose të turpshme, ndërsa ndani ekranin e kompjuterit tuaj. Një tjetër mundësi është të konsideroni ndarjen vetëm të programit që dëshironi të shfaqni në vend që të ndani të gjithë ekranin e kompjuterit tuaj.

Këto teknologji janë mjete fantastike, në shumë mënyra, përfaqësojnë të ardhmen se si do të punohet, bashkëpunohet dhe komunikohet me të tjerët. Këta hapa të thjeshtë do t'ju ndihmojnë të ecni suksesshëm në mënyrë të sigurt.

Editor

Materiali është marrë nga trajnimet The SANS Institute (the Escal Institute of Advanced Technologies), dhe është përshtatur në buletin (Newsletter) nga Sektori i Mbrojtjes Kibernetike, në kuadër të Departamentit për Komunikim dhe Teknologji Informative.

Ju lutem nëse keni ndonjë paqartësi, mos hezitoni të na kontaktoni.